




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



Nr. 3220/2 Prot

Dt. 15.07.22



Nr. 369/5 Prot.

Shkodër, më 15/07.2022

Lënda: Mbi Vendimin nr. 35, datë 26.05.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, pas administrimit të shkresës së ZABU Drin-Bunë nr. 237/1 prot., datë 05.07.2022 në përgjigje të shkresës së Prefektit nr. 369/3 prot., datë 15.06.2022 “Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 35, datë 26.05.2022 “Për dhënien në përdorim me afat 9 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 2.1 ha, nga e cila 0.1 për depozitim inerte dhe 2 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje, kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhëse etj”, ngastra nr. 14, ekonomia pyjore Drin Gjadër Kir, rezulton se kjo sipërfaqe përfshihet në brigjet e lumit Drin dhe janë nën administrimin e Zyrës së Administrimit të Baseni Drin-Bunë.

Në këto kushte, në referencë të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 27, pika 5, neni 54/e.1”, neni 55, pika 3 dhe 4, është në tagrin e Këshillit Bashkiak dhënia në përdorim e pronave me qëllim nxjerrjen e të ardhurave, por praktika të tilla duhet të trajtohen njëkohësisht edhe sipas ligjit të posaçëm nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 66 dhe nenin 67, i ndryshuar, sipas të cilat është detyrim marrja e autorizimit të posaçëm për ushtrim aktiviteti nga zyra e administrimit të burimeve ujore Drin-Bunë (nëpërmjet vendimarrjes së Këshillit të Basenit).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 35 datë 26.05.2022



“Për dhënien në përdorim me afat 9 vjecar sipërfaqen pyjore prej 2.1 ha “nga e cila 0.1 ha për depozitim materialesh inerte dhe 2 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”.

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” **me shumicë të cilësuar votash.**

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej **2.1 ha** në ngastrën nr. 14, Ekonomia Pyjore **Drin Gjader Kirë** ,nga e cila **0.1 ha** për depozitim materialesh inerte dhe **2 ha** për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj) .
2. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.
3. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
4. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R
Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Ardian Çelepija

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 21

Vota Kunder -

Vota Abstenim 1 (100%)

Zbardhur me datë 01.06.2022